

AKTTHEMELIMI DHE STATUTI

I

SHOQËRISË “ELOKRI” Sh.p.k

TITULLI I

THEMELIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

THEMELIMI, EMRI DHE THEMELUESIT

Më datë 20.11.2023 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“ELOKRI” sh.p.k**, e cila është regjistruar, vepron dhe organizohet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Ortak i vetëm i shoqërisë është:

Z. Piro Angjeli, atësia Llazar, lindur më 03.06.1975 në Sarandë edhe banues në Tiranë në adresën: Rruga Donika Kastrioti vila 9/1, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letrënjoftimit ID Nr. 038648470 dhe nr.personal H50603143L.

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **“ELOKRI”sh.p.k** është:

“Ndërtimi, operimi dhe vënia në punë e hidrocentraleve, parqeve fotovoltaike, eolike dhe burimeve të tjera të energjisë së rinovueshme. Prodhimi, transmetimi, shpërndarja e energjisë elektrike dhe nëse është e nevojshme importimi i saj. Mirëmbajtja e centraleve dhe parqeve të prodhimit të energjisë elektrike. Importimi i mallrave dhe pajisjeve të teknologjisë që do të përdoren për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe operimin e centraleve të energjisë. Shoqëria mund të ushtroj çdo aktivitet tregtar tjetër që nuk është i ndaluar ng ligji”.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë **“ELOKRI” sh.p.k** është e pakufizuar. Ajo mund të pushojë veprimtarinë e saj në çdo moment, sipas vendim të Ortakut të Vetëm, sipas përcaktimeve ligjore.



NENI 4
SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë **“Rruga Donika Kastrioti Vlila 9/1” sh.p.k** është në Tiranë.

NENI 5
DEGËT, ZYRAT E PËRFAQËSIMIT DHE PJESËMARRJET

Shoqëria në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi mund të hap degë ose zyra përfaqësimi në Shqipëri ose jashtë saj dhe të fillojë dhe/ose të marrë pjesë në aktivitete të tjera të çdo forme.

TITULLI II
KAPITALI, KUOTAT

NENI 6
KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 Lekë (njqind Lekë) dhe përbëhet tërësisht nga kapital në para. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Kapitali themeltar perbehet nga 1 (nje) kuote me vlerë nominale të barabartë prej 100 (njqind) Lekë.

Ortaket themelues

1. Ortak i vetem dhe themelues Z. Piro ANGJELI Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë nominale të barabartë prej 100 (njqind) Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 7
ÇERTIFIKATAT E KUOTAVE TË KAPITALIT

Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.



NENI 8 KALIMI I KUOTAVE ME KONTRATE

Pjesët/kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe i njoftohet selisë së regjistruar të shoqërisë.

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

NENI 9 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Ortaku i Vetëm me vendim mund të zmadhojë kapitalin, duke rritur numrin e kuotave ekzistuese ose duke rritur vlerën nominale të tyre. I njëjti vendim kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



TITULLI III
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 10
FUNKSIONET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 9901, datë datë 14.4.2008 PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen

TITULLI IV
ADMINISTRATORËT

NENI 11
ADMINISTRIMI

- 1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 2) Administratorët e nje shoqërie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratorë te nje shoqërie te kontrolluar dhe anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundërshtim me ligjin ne keto dispozita eshte i pavlefshem.
- 3) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i vetem i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar me te drejte ripërtëritje, emërimi: Znj. Arjola KOLA , lindur më 11/02/1983 në Durrës, banuese ne Tirane, mbajtëse e Leternjofimit me numer 033805494 dhe numer personal I35211159L madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

NENI 12
KOMPETENCAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë

së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për

Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë

vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.


Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17

e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

5



1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë

dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ,

kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.



6

TITULLI V DIVIDENDËT DHE KAPITALIZIMI I FITIMEVE

NENI 13 DIVIDENDËT

Pas përmbushjes së kërkesave të Nenit 77 të Ligjit, shoqëria, me anë të një vendimi të kualifikuar, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse kuotat emetohen me kushtin se merr dividend duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë kuota në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti. Asnjë dividend dhe asnjë mjet monetar i pagueshëm në lidhje me një kuotë nuk mund të fitojë interesa nga shoqëria nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat që i lidhen kuotës. Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë.

TITULLI VI PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 14 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohe:

- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- Me vendim të ortakut të vetëm ose Asamblesë së Përgjithshme;
- Me hapjen e procedurave të falimentimit.
- Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr.9723 datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- Me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri në likuidim e sipër”. Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese. Likuidimi i shoqërisë bëhet sipas përcaktimeve në ligjin “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 15

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 16

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 17

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptar.

NENI 18

Njoftimet

Njoftimet për ortakët do të bëhen me postë, në adresën e fundit të komunikuar me çdo ortak. Në momentin e krijimit të kushteve, njoftimet bëhen edhe me postë elektronike.

NENI 19

Dispozita të fundit

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me ligjin shqiptar.

Ky Statut u hartua në 2 kopje, një kopje për Qendrën Kombëtare të Biznesit një kopje Administratori dhe Ortaku i Kompanisë. Ky Statut u hartua në gjuhën Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon.


ORTAKU I VETËM

I

SHOQËRISË “ELOKRI” sh.p.k

PIRO ANGJELI

Piro Angjeli



8